

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze: Date / Dana: 16 106 2022		
Nr. Orgv Org. Jed. 01	Nr. Prot. Br. Prot. 130	Nr. Faqeve. Br. Strana. 4
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
 KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
 MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
 E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

Procesverbal nga konsultimi publik për Plotësim-Ndryshimin e Strategjisë për Rini

Data: 02.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal- Ferizaj

Ora e fillimit: 10:05

Mbledhjen e hapi Udhëheqësja e Sektorit të Rinisë, znj. Dashurije Ahmeti, në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.

Në fjalën hyrëse, znj. Ahmeti prezantoi plotësim-ndryshimet e Strategjisë për Rini, duke theksuar se për herë të parë është harmonizuar një dokument strategjik lokal me agjendat e Kombeve të Bashkuara, konkretisht me agjendat "Youth, Peace and Security (YPS)" dhe "Women, Peace and Security (WPS)".

Ajo bëri të ditur se, në bashkëpunim me UNDP dhe UNFPA, është siguruar materiali i nevojshëm për inkorporimin e këtyre agjendave në Strategjinë për Rini dhe në Planin e Veprimit.

Gjatë prezantimit u theksua përfshirja e aktiviteteve të reja, si:

- Programet e monitorimit për të rinjtë;
- Shkollat e lidërshipt;
- Trajnimet për fuqizimin dhe përfshirjen e grave në proceset vendimmarrëse.

Po ashtu, u potencua rëndësia e realizimit të analizave gjinore për secilin projekt, me qëllim të



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr: "Dëshmorët e Kombit" p.n.

vlerësimit të nivelit të përfshirjes së grave dhe vajzave në aktivitetet dhe projektet e planifikuara.

Lidhur me sigurinë dhe mirëqenien sociale, u theksua se Kosova vazhdon të përballlet me raste të dhunës në familje, ndërsa përmirësimi i qasjes në shërbime për viktimat e dhunës është paraparë si aktivitet i veçantë, i cili do të realizohet përmes pikave të referimit dhe qendrave mbështetëse.

Gjithashtu, u diskutua çështja e sigurisë fizike të të rinjve jashtë objekteve shkollore. Në këtë drejtim, Plani i Veprimit parasheh ndërmarrjen e masave konkrete, hartimin dhe zbatimin e protokolleve përkatëse nga institucionet dhe organizatat relevante, si dhe shpërndarjen e materialeve vetëdijesuese.

Në kuadër të promovimit të barazisë gjinore, u theksua rëndësia e respektimit të kuotës gjinore në mekanizmat rinorë dhe proceset vendimmarrëse, duke synuar përfaqësim të barabartë të grave dhe vajzave.

Po ashtu, u diskutua roli i Këshillit Lokal Rinor, nevoja për nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe rregulloreve komunale, si dhe ndërmarrja e masave të tjera që kontribuojnë në përmirësimin e pozitës së të rinjve.

Vëmendje e veçantë iu kushtua përfshirjes së komuniteteve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në aktivitete dhe procese vendimmarrëse.

Gjatë diskutimit u theksua se Komuna e Ferizajt është komuna e parë në Kosovë që integron në



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

dokumentet e saj strategjike agjendat YPS dhe WPS, të cilat fokusohen në mbrojtjen nga dhuna, fuqizimin e grave dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në të gjitha nivelet. Gjithashtu u bë e ditur se integrimi i këtyre agjendave është shoqëruar edhe me planifikim buxhetor.

Më pas, fjalën e mori Aolta Bajrami, e cila falënderoi Udhëheqësen e Sektorit të Rinisë për gatishmërinë dhe angazhimin e vazhdueshëm në avancimin e proceseve rinore. Ajo theksoi se një nga sfidat kryesore ka qenë mosnjohja e punës vullnetare si përvojë pune, por se këtë vit Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka lansuar platformën për regjistrimin e orëve vullnetare, gjë që përbën një hap të rëndësishëm për vlerësimin e kontributit të të rinjve.

Tutje, ajo vlerësoi punën e institucionit dhe të të gjithë akterëve të përfshirë në procesin e plotësim-ndryshimit të Strategjisë për Rini, duke theksuar se janë trajtuar dhe adresuar një numër i madh fushash me interes për të rinjtë.

Megjithatë, ajo shprehu shqetësimin për pjesëmarrjen e ulët të të rinjve në diskutimin publik, duke potencuar se të gjithë të interesuarit mund të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre deri në momentin e procedimit të dokumentit për votim.

Pyetje nga pjesëmarrësit:

A janë ftuar shkollat për të marrë pjesë në diskutimin publik?

Përgjigjja e znj. Dashurije Ahmeti:

Shkollat nuk janë ftuar në këtë fazë, pasi në proceset e tilla zakonisht marrin pjesë organizatat rinore dhe akterët që janë vazhdimisht të përfshirë në çështjet rinore. Një arsye shtesë ka qenë edhe përfundimi i vitit shkollor dhe angazhimet e nxënësve me teste dhe vlerësime, me



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

qëllim që të mos ngarkohen më tej.

Ajo shtoi se, në bashkëpunim me UNDP-në, është planifikuar organizimi i një punëtorie ku do të ftohen të gjithë kontribuuesit në procesin e plotësim-ndryshimit të Strategjisë për Rini, për të diskutuar edhe një herë përmbajtjen e dokumentit.

Në përmbyllje, znj. Ahmeti theksoi se puna në hartimin dhe përmirësimin e dokumenteve strategjike nuk është e lehtë, por se gjatë gjithë procesit nuk ka munguar vullneti institucional për të punuar në avancimin e politikave rinore.

Diskutimi publik u mbyll në ora 10:36.

Procesmbajtëse: Aolta Bajrami